



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më datë:	06.12.2021
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	02-469

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT
DEKANATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Për/Za/To:	Këshillin e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) Prof. Asoc. dr. Isuf Lushi, kryesues i Këshillit të Fakultetit
Nga/Od/From:	Komisioni vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në FSHJM Prof. Ass. Dr. Albana Milaimi – kryetare Prof. Ass. Dr. Kushtrim Braha – anëtar Prof. Ass. Dr. Ylli Kortoçi – anëtar
Datë/a:	06.12.2021
Tema/Subjekat/Subject:	Propozimet për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

**RAPORT PËR ANGAZHIM TË BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM PËR
LIGJËRATA DHE USHTRIME PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022, SEMESTRI
DIMËROR**

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, dhe nenin 7 të rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve në Universitetin "Ukshin Hoti" si dhe bazuar në konkursin e shpallur nga Senati i Universitetit, sipas referencës nr. prot. 02-417, të datës 26.11.2021 si dhe në kuptim të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, sipas referencës nr. prot. 01-97, të datës 27.09.2021 mbi formimin e komisionit për vlerësimin e kandidatëve aplikues, komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit angazhimin e kandidatës si vijon:

1. Një mësimdhënës për lëndën mësimore: Kimi (3 orë L)

Kandidatët e paraqitur sipas radhës së aplikimit (Nr. protokollit) janë:

1. **Dr. Sc. Valbonë Mehmeti**
2. **Prof. Dr. Azem Lajçi**
3. **Msc. Mentor Ismaili, PhD_(c)**
4. **MSc. Belma Nallbani PhD_(c)**

Dokumentet relevante:

- a) Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren me nr. prot. 01-17 e datës 28.01.2020, neni 7, pika 2.1; 4 dhe 8 për procedurat vlerësuese.
- b) Kriteret e konkursit (dokumentacioni i kompletuar, publikimet shkencore, përvoja në fushën përkatëse, konflikti i interesit etj.)

Tabela e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërues sipas Rregullores nr. 01-17 e datës 28.01.2020

Nr.	Kandidati/ja	Neni 7. pika 2.1			Neni 7. pika 4	Neni 7. pika 10	Publikimet shkencore?	Angazhimi sipas Rregullores Nr. 01-17 e datës 28.01.2020
		Grada shkencore Dr. sc.?	Dr. sc. adekuat?	Thirrje akademike në ndonjë Universitet publik?	Përvoja në UPZ?	Konflikt interesi, afërsia familjare?		
1.	Valbonë Mehmeti	PO	PO	JO	JO	JO	PO	Propozohet për angazhim
2.	Azem Lajçi	PO	PO	PO	JO	JO	PO	Nuk propozohet për angazhim
3.	Mentor Ismaili	/	/	JO	JO	JO	PO	Nuk propozohet për angazhim
4.	Belma Nallbani	/	/	JO	JO	JO	PO	Nuk propozohet për angazhim



Kandidatja e propozuar në lëndën mësimore Kimi (**Dr. Sc. Valbonë Mehmeti**) i plotëson më së miri kriteret e parapara në konkursit sipas referencës nr. prot. 01-250, të datës 15.09.2021. E njëjta është Dr. Sc. i Shkencave të Kimisë.

Kandidati: **Prof. Dr. Azem Lajçi** edhe pse i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në Konkurs, sipas referencës nr. prot. 01-250, të datës 15.09.2021, nuk propozohet sepse i njëjti është pensionuar më datë: 03.05.2021 në zbatim të dispozitave të Ligjit të Punës.

Kandidatët: **MSc. Belma Nallbani (Mastër i Shkencave në Bioinxhinieri, Ref. Nr. 6-1452; më: 23.01.2018)** dhe **Msc. Mentor Ismaili (Mastër i Shkencave të Kimisë)** nuk i plotësojnë kriteret e parapara në konkurs, ngaqë kanë gradën shkencore: Msc. Kandidatët aplikantë janë studentë në studimet e doktoratës (komisioni ka dëshmi të tillë), por nuk i kanë përfunduar studimet në fjalë.

Udhëzim Juridik: Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në komisionin për ankese në FSHJM, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të vendimit të Këshillit të FSHJM-së (miratimit të këtij raporti).

Komisioni:

1. Prof. Ass. Dr. Albana Milaimi – kryetare 
2. Prof. Ass. Dr. Kushtrim Braha – anëtar 
3. Prof. Ass. Dr. Ylli Kortoçi – anëtar _____